

Përshëndetje,

Dëshiroj t'ju uroj mirëseardhjen në lançimin e rezultateve kryesore të anketës “Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri”.

Së pari më lejoni të falenderoj bashkëpuntorët tanë në përgatjen e këtij publikim si dhe të gjithë të ftuarit nga institucionet qeveritare, politikëbërësit, organizatat e huaja, organizatat jofitimprurëse etj., duke synuar që ky takim të shërbejë në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

Kjo dukuri, e pranishme në nivel global, është një nga shkeljet më të mëdha të të drejtave të njeriut në shoqërinë ku jetojmë sot, duke përfshirë thuajse të gjithë grupmoshat dhe komunitetet, si dhe një nga çështjet më kritike, të cilat kërkojnë marrjen e masave të menjëhershme dhe zgjidhje të problematikave. Ndaj, shpresoj që ky takim të shërbejë si një shtysë për të nxitur dhe lëvizur mekanizmat shtetërorë, organizatat e huaja, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë për ta luftuar këtë dukuri me të gjithë format dhe mënyrat.

Kjo anketë, mat lloje të ndryshme të dhunës si ato psikologjike, fizike dhe seksuale të ushtruar ndaj grave dhe vajzave nga partnerët e tyre, persona jo partner si dhe ngacmimin seksual e përndjekjen. Krahas dhunës në familje dhe elementëve që lidhen me të në vetvete, anketa e kryer në vitin 2018, ka disa risi të cilat do të bëhen publike sot, për herë të parë, të cilat lidhen me dhunën e ushtruar në një lidhje, ku përfshihen sjelljet kontrolluese, dhuna ekonomike, dhuna psikologjike, dhuna fizike dhe dhuna seksuale. Gjithashtu, për herë të parë nëpërmjet këtij vrojtimi, është matur dhe ngacmimi seksual dhe përndjekja.

Rezultatet e anketës në tërësi tregojnë për ulje të prevalencës së dhunës në familje në të gjitha llojet e saj, në krahasim me 2013.

Më në detaj, për dhunën në familje të përjetuar ndonjëherë në jetë, 47 % e grave që kanë një partner ose që kanë patur një partner me të cilin kanë bashkëjetuar, kanë qenë subjekt i njëjës prej llojeve të dhunës gjatë gjithë jetës së tyre. Kjo shifër ka rënë nga viti 2013 me rreth 19 p.p., por ende mbetet shumë e lartë dhe shqetësuese. Ndërsa, për dhunën në familje, të përjetuar vitin e fundit, shifrat tregojnë se 33,7 % e grave kanë qenë subjekt i njëjës prej llojeve të dhunës.

Sipas rezultateve të anketës, 41,2 % e grave kanë qenë subjekt i sjelljeve kontrolluese gjatë gjithë jetës së tyre. Në krahasim me mesataren e vendeve të Bashkimit Evropian, ku ky tregues është 35 %, kjo vlerë mbetet ende shumë e lartë edhe pse në raport me vitin 2013, ka pësuar një rënie me 10 p.p.

Interesante janë faktet për dhunën ekonomike, ku sipas të dhënave, në Shqipëri në vitin 2018, rreth 7 % e grave deklarojnë se gjatë gjithë jetës kanë përjetuar një lloj dhune ekonomike nga partneri, ndërkohë që mesatarja për abuzimin ekonomik gjatë jetës, në vendet e BE-së është 12 %, pra më e lartë.

Sipas rezultateve të anketës, 18 % e grave tregojnë se kanë përjetuar dhunë fizike të paktën një herë në jetë nga partneri aktual ose i mërrparshëm, edhe pse shifrat tregojnë se për vitin 2013, ky tregues ka qenë me një rënie 5,7 p.p.

Në vitin 2018, 8,6 % e grave deklarojnë se kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë jetës së tyre. Për vitin 2013 ky tregues ka qenë 7,9 %, me një rritje prej 0,7 p.p.

Sic e theksova dhe më parë, gjatë kësaj ankete janë matur dhe disa rezultate të reja që sot do të publikohen për herë të parë, dhe këto shifra tregojnë se 65,8 % e vajzave ose grave në një lidhje, por që nuk bashkëjetojnë me partnerin përjetojnë sjellje kontrolluese.

Të dhënat tregojnë se 18,1 % e grave tregojnë se kanë përjetuar një ngacmim seksual gjatë jetës. Ndërkohë, 8,5 % e grave deklarojnë se kanë përjetuar ngacmim seksual vitin e fundit. Mesatarja për vendet e BE-së për këtë tregues është 13 % dhe nëse Shqipëria do të renditej në vendet anëtare do të ishte në vendin e 24.

Ky publikim, është mjaft i pasur me të dhëna, të cilat do ti zbuloni gjatë prezantimit të mëtejshëm. Ai do të shërbejë dhe si një mjet për të monitorur politikat vendimmarrëse me bazë gjinore të politikëbërësve, por nga ana tjetër do të jetë dhe një burim informacioni për të kryer analiza të thelluara në këtë fushë.

Indikatorët gjinorë, prej kohësh tashmë janë pjesë e agjendës së INSTAT dhe ndër vite kanë sjellë një bashkëpunim shumë të mirë me organizatat ndërkombëtare, duke theksuar rolin e statistikave për një politikëbërje të mirë me bazë gjinore. Në përmbushje të këtij misioni, më lejoni të nënvijëztoj rolin e Agjendës 2030, e cila i jep instituteve të statistikave një

rol kryesor në monitorimin e arritjes së objektivave, gjë që përbën një mundësi të madhe për INSTAT.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), synojnë të adresojnë çështje të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor, përveç objektivit 5 i cili është tërësisht i dedikuar barazisë gjinore, treguesit gjinorë janë të përfshirë në të 17 objektivat nëpërmjet të cilave synohet të adresohen çështjet e barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

Nga ana tjetër, OZHQ-të përbëjnë një sfidë shumë të madhe. Sidomos për vendet si Shqipëria, ku ka mungesë të dhënash administrative. Në kuadër të OZHQ-ve, UN Woman ka iniciuar programin “Gratë Vlejnë”, nëpërmjet të cilit synohet të zhvillohen instrumentat e duhura për të matur arritjen e OZHQ-ve me bazë gjinore. Unë jam shumë e lumtur që Shqipëria është pjesë e këtij programi, nëpërmjet të cilit është financuar dhe studimi i dhunës në familje që paraqitet për publikun sot.

Gjithashtu, dua të falenderoj programin për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje të UNDP, UN Woman dhe UNFPA, të financuar nga SIDA, dhe veçanërisht stafin e këtyre agjencive për mbështetjen e këtij studimi, si dhe ekspertin ndërkombëtare Znj. Robin Haarr për ekspertizën teknike dhe hartimin e këtij raporti mjaft cilësor dhe të detajuar.

Të drejtat e grave janë thelbësore për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, paqes dhe sigurisë kombëtare dhe është roli ynë si statisticienë dhe si gra që të japim kontribut në ndryshimet pozitive të lidhura me zhvillimin e shoqërive ku jetojme.

Faleminderit!